



Në bazë të nenit 12, paragrafi 1, shkronja (d) dhe 40, paragrafi 2, shkronja (h), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e konform nenit 11, lidhur me nenin 28 paragrafi 2, pika (h), dhe 29, paragrafi 2, pika (d), të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, Vendimit të Kuvendit të Komunës, 01-Nr-16-887, të datës 23.02.2011, e në mbështetje të nenit 10, pika 3, të Rregullores për procedurat e ndarjes së çmimit “Ukë BYTYÇI” 01-Nr-16-5820, të datës 29.09.2011, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datën 26.09.2024, miratoi këtë:

V E N D I M

Për miratimin e propozimit të komisionit për ndarjen e çmimit “Ukë BYTYÇI”

Neni 1

Çmimi “Ukë BYTYÇI” për Udhëheqje të mirë, në sektorin publik i ndahet z. **Sali ASLLANAJ**, nga fshati Gjinoc Komuna e Suharekës.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset, Kryetari i Komunës në Suharekë.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-016-56307
Me datë 26.09.2024



Kryesuesi Kuvendit
Mr.ec Bexhet KUÇI